LIGJ
Nr.7552, datë 22.1.1992

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.4976, DATË 29.6.1972 "PËR PENSIONET E ANËTARËVE TË KOOPERATIVAVE BUJQËSORE"

Në bazë të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr.4976, datë 29.6.1972 "Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore" neni 4 paragrafi i parë ndryshohet si vijon:

"Anëtari i kooperativës bujqësore ka të drejtë të marrë pension pleqërie, kur ka plotësuar moshën burri 60 vjeç dhe kur ka 25 vjet vjetërsi punë, kurse gruaja 55 vjeç dhe ka 20 vjet vjetërsi punë".

Neni 2

Neni 9/a ndryshon si vijon:

"Invalidi i grupit të tretë e merr pensionin e invaliditetit, pavarësisht nëse punon apo nuk punon dhe pavarësisht nga të ardhurat që realizohen nga puna.

Neni 3

Në nenin 10 shkronja "b" ndryshon si vijon:

"Prindërit, birësuesit dhe bashkëshortët që kanë mbushur moshën burrat 60 vjeç dhe gratë 55 vjeç, ose edhe nën këtë moshë, në qoftë se janë të paaftë për punë".

Neni 4

Në nenin 12 paragrafi i parë dhe i dytë ndryshohen si vijon:

"Anëtari i kooperativës bujqësore që ka mbushur moshën burri 60 vjeç dhe gruaja 55 vjeç, por nuk ka plotësuar vjetërisnë në punë për të fituar pension pleqërie të plotë, ka të drejtë të marrë pension pleqërie të pjesshëm, në qoftë se ka vjetërsi në punë; burri jo më pak se 12 vjet e gjysëm dhe gruaja jo më pak se 10 vjet.

Në kooperativat bujqësore që janë ngritur pas 1 janarit 1966, anëtari i kooperativës përfiton pension pleqërie të pjesshëm, kur ka mbushur moshën burri 60 vjeç e gruaja 55 vjeç dhe ka vjetërsi në punë burri jo më pak se 10 vjet dhe gruaja jo më pak se 8 vjet".

Neni 5

Pensioni minimal i ish-anëtarëve të kooperativave bujqësore të mos jetë më i vogël se 80 për qind i pensionit minimal të punonjësve të ndërmarrjeve bujqësore.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi më 1 tetor 1991.

Shpallur me dekretin nr.119, datë 1.2.1992 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ramiz

Alia.